



Hamdi Mramori Street, No 1  
Prishtina 10000 – Kosovo  
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 101  
Fax: +381 (0) 38 247 620  
e-mail: [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org)  
[www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)

# **Procedura e Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale (KQKO)**

# Përmbajtja

## Baza Ligjore

<b>1.</b>	<b>Aplikueshmëria dhe struktura e Procedurës së Administrimit</b>	<b>1</b>
1.1	Aplikueshmëria	1
1.2	Struktura e Procedurës së administrimit	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>2.</b>	<b>Themelimi, Definimet, Interpretimet dhe Objektivat</b>	<b>2</b>
2.1	Definimet dhe interpretimet	2
2.2	Objektivat e KQKO	3
<b>3.</b>	<b>Anëtarsia e Komisionit</b>	<b>5</b>
3.1	Anëtarët	5
3.2	Nën - Komisionet	6
3.3	Grupet Punuese	6
<b>4.</b>	<b>Emrimi, Largimi dhe Dorëheqja e Anëtarëve të tjerë përveç Kryesuesit</b>	<b>7</b>
4.1	Emrimi i Anëtarëve	7
4.2	Kryesuesi	8
4.3	Sekretari	9
4.4	Aletrnativët	10
4.5	Posti i Zbrazët i Anëtarësis	10
<b>5.</b>	<b>Përgjegjësitë e Anëtarit</b>	<b>12</b>
5.1	Përgjegjësitë	12
5.2	Dispozitat e Adresave	12
<b>6.</b>	<b>Takimet, Propozimet dhe Votimi</b>	<b>13</b>
6.1	Takimet Tremujore	13
6.2	Vendmbajtja e Takimeve	13
6.3	Takimet shtesë	13
6.4	Njotimi dhe Agjenda e Takimeve	13
6.5	Procedurat e Takimit	14
6.6	Përfaqësimi	14
6.7	Propozimet	15

6.8	Votimi	16
6.9	Proqesverbali	16
6.10	Gjuhët e Punës	16
<b>7.</b>	<b>Shpenzimet e Përgjithëshme dhe të Posaqme</b>	<b>18</b>
7.1	Shpenzimet e përgjithëshme të KQKO-së	18
7.2	Shpenzimet e Ekspertëve Teknik (këshillatrët Profesional)	18
<b>8.</b>	<b>Ndryshimet e Procedurës së Administrimit</b>	<b>19</b>

# **Bazat Ligjore**

Në përputhje me Nenin 26.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në seancën e mbajtur me ..... ka aprovuar Procedurën për Menaxhim të Kodeve Teknike dhe Operacionale siç është përcaktuar në Nenin 38.7 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

## **1. Aplikueshmëria dhe Struktura e Procedurës**

### **1.1 Aplikueshmëria**

Kjo procedurë zhvillon procedurat qeverisëse për shqyrtim dhe aprovim të Kodeve Teknike/Operative në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë.

Këto procedura qeverisëse themelojnë “Procedurat dhe Rregullat e Komisionit” të përgaditura nga anëtarët ose organet e ndryshme në sektorin e energjisë elektrike/energjisë të cilët do të shqyrtojnë:

- Kodet e Rrjetit, Shpërndarjes dhe Matjes;
- Kodet e Paisjeve dhe Standardeve Elektrike;
- Kodi për Mbrojtjen e Konsumatorëve.

### **1.2 Struktura e procedurës së administrimit**

Procedura është e ndarë në 7 paragrafe të mëtutjeshme, si në vijim:

- Paragrafi 2 përcakton themelimin, definimet, interpretimet dhe objektivat e Komisionit;
- Paragrafet 3 dhe 4 përshkruajnë antarësinë, emërimin dhe largimin e anëtarëve të Komisionit;
- Paragrafet 5 dhe 6 mbulojnë përgjegjësitë e Anëtarëve të Komisionit dhe qështjet e takimeve, kompetencat për propozime dhe votime; dhe
- Paragrafi 7 dhe 8 përshkruajnë alokimin e shpenzimeve dhe ndryshimet në Procedure të Administrimit.

## 2. Themelimi, Definimet, Interpretimet dhe Objektivat

### 2.1 Definimet dhe interpretimet

Fjalët dhe shprehjet në vazhdim do të kenë kuptimin në vazhdim në këtë procedurë:

- "Zëvendësues" nënkupton individin e emruar nga Emëruesi për ta përfaqësuar atë në takimet e Komisionit kur ai mungonë;
- "Emërues" nënkupton një trup emërues të palëve të referuara në Rregulla i cili ka të drejtë të emëroj Anëtarin ose Anëtarët e Komisionit;
- "Ditë Pune" nënkupton çdo ditë tjetër përveq (a) çdo të shtune ose të Djele ose (b) ndonjë ditë tjetër e cila është pushim publik në Kosovë;
- "Kryesuesi" nënkupton personin e emëruar të jetë Kryesues zëvendësi i tij ose personi i emruar që të veproj si Kryesues i takimit i emruar nga Anëtarët në mungesë të Kryesuesit ose të zëvendësuesit të Kryesuesit;
- "KQKO"-ja nënkupton Komisionin Qeverisës të Kodeve Operacionale (KQKO) të themeluar për të shqyrtuar Kodet teknike dhe operacionale në Industrinë e Energjisë Elektrike në Kosovë;
- "Statuti" nënkupton statuti dhe rregullat e Komitetit për Qeverisjen e Kodeve Operacionale (KQKO) ashtu siç është vendosur në këtë dokument;
- "Operator i Stistemit të Distribucionit "nënkupton poseduesin e licencës sipas Kapitullit 7 , Nenit 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
- "ZRRE" nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji siç është mandatuar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
- "Gjeneruesit" nënkupton poseduesin e licencës për gjenerim sipas Kapitullit 3, Nenit 5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
- "Gjeneruesit e pamvarur" nënkupton çdo gjenerues tjetër përveq Gjeneruesit të KEK-ut;
- "Anëtar" nënkupton një person i emëruar sipas rreullave për të qenë anëtar i, ose Kryesues i, Komisionit dhe referimet në një "Anëtar" në këtë Statut do të, përveç nëse kontesti e kërkon ndryshe, përfshinë Kryesuesin;
- "Furnizues Publik " nënkupton funksionin e KEK-ut për furnizim publik me energji elektrike siç është treguar në kapitullin 6, Neni 21 i Ligjit për Energji Elektrike;
- "Pala Interkonektuese" - nënkupton subjektin e licencuar që mund të tregtoj përmes linjave që lidhin OST me palët jashtë domenit të OS;

- "Sekretar" nëkupton personin e emruar nga OPSTT-ja si sekretar i Komisionit sipas këtij Statuti;
- "Furnizues" nëkupton poseduesin e licencës sipas Kapitullit 7 Neni 28 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, 2004;
- "Tregëtar" nëkupton poseduesin e licencës sipas Kapitullit 6, Neni 23 i Ligjit për Energji Elektrike;
- "Operator i Sistemit të Transmisionit", si term, është sinonim i termit
- "Operator i Sistemit të Transmisionit" i cili do të mbizotroj në këtë Statut;
- "Operator i Sistemit të Transmisionit" nëkupton poseduesin e licencës sipas Kapitullit 7 Neni 32 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Në këtë procedurë, përveç nëse kontesti nuk e kërkon ndryshe:

- fjalët dhe shprehjet e përdorura përveç nëse nuk janë definuar qëllimisht në këtë Status do të kenë të njëjtin kuptim ashtu siç është definuar në Kodet e Rrjetit, Distribucionit, Matjes; Kodet e Paisjeve dhe Standardeve elektrike dhe Kodin për Mbrojtjen e Konsumatorëve;
- fjalët që tregojnë njëjës gjithashtu përfshijnë shumsin dhe e kundërta; fjalët që tregojnë gjininë mashkullore gjithashtu përfshijnë atë femërore dhe e kundërta;
- temat dhe titujt e seksioneve nuk do të merren në konsideratë në interpretimin ose ndërtimin e fjalëve dhe shprehjeve të përdorura;
- referimi në person përfshinë të licensuarit.

Kjo procedurë do të nënshtrohet aprovimit të ZRRE-së.

## **2.2 Objektivat e KQKO-së**

Objektivat e KQKO-së janë:

- në mënyrë të përgjithëshme të shqyrtoj dhe diskutoj Kodin e Rrjetit, Distribucionit dhe atë të Matjes si dhe zbatimin e tyre;
- në përgjithësi shqyrtoj dhe diskutoj Kodet e Standardeve dhe Pajisjeve të energjisë elektrike si dhe zbatueshmërinë e tyre;

- në përgjithësi shqyrtoj dhe diskutoj Kodin për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe zbatueshmërin e tij;
- shqyrton dhe diskuton të gjitha sygjerimet për ndryshime në Kodin e Rrjetit, Kodin e Distribucionit dhe Kodin e Matjes me KOSTT, OSD, ZRRE-në, ndonjë përdorues ose ndonjë përdorues potencial mund të dorzohet në KOSTT për tu konsideruar nga KQKO-ja kohë pas kohe;
- shqyrton dhe diskuton të gjitha sygjerimet për ndryshime në Kodet për Standarde dhe Pajisje të Energjisë Elektrike që ndonjë përdorues ose ndonjë përdorues i mundëshëm mund të dorzohet në KOSTT për tu konsideruar nga KQKO-ja kohë pas kohe;
- shqyrton dhe diskuton të gjitha sygjerimet për ndryshime në Kodin për Përkujdesje të Konsumatorëve të cilat furnizuesi publik KEK-u, ndonjë përdorues ose ndonjë përdorues i mundëshëm mund të dorzohet në KOSTT për tu konsideruar nga KQKO-ja kohë pas kohe;
- diskuton çfarë ndryshimesh/modifikimesh janë të nevojshme në Kodin e Rrjetit, Kodin e Distribucionit dhe Kodin e Matjes që del nga ndonjë rrethanë e paparashikuar të cilës i referohet KOSTT ose OSD-ja në përputhje me Kodet e Rrjetit, Distribucionit ose Matjes;
- diskuton se çfarë ndryshimesh/modifikimesh janë të nevojshme për tu bërë në Kodet për Standardet dhe Pajisjet e Energjisë Elektrike që dalin nga ndonjë rrethanë e paparashikuar të cilës i referohet KOSTT-i ose nga ndonjë shfrytëzues ose shfrytëzues i mundëshëm;
- Diskuton çfarë ndryshimesh/modifikimesh janë të nevojshme për tu bërë në Kodin për Mbrojtje të Konsumatorëve që dalin nga ndonjë rrethanë e paparashikuar të cilës i referohet Furnizuesi Publik ose nga ndonjë shfrytëzues ose shfrytëzues i mundëshëm;
- bën dhe publikon (në ueb-faqen e OPSTT-së) rekomandime dhe siguron që janë bërë konsultime me shfrytëzuesin për ato rekomandime përmes anëtarëve të KQKO-së.

### 3. **Anëtarsia e Komisionit**

#### 3.1 **Anëtarët**

KQKO-ja do të përbëhet nga:

- 1 Kryesues;
- 1 Sekretar pa të drejt vote;
- 1 person i emëruar nga dhe që përfaqësonë të licencuarin e OPSTT-së;
- 1 person i emëruar nga dhe që përfaqësonë të licencuarin e OSD-KEK;
- 1 person i emëruar nga dhe që përfaqësonë të licencuarin e Gjenerimit - KEK;
- 1 person i emëruar nga dhe që përfaqësonë të licencuarin e Furnizuesit Publik - KEK;
- 1 person i emëruar nga dhe që përfaqësonë ZRRE-në;
- 1 person i emëruar nga dhe që përfaqësonë Gjeneruesit e Pavarur;
- 1 person i emëruar nga dhe që përfaqësonë Furnizuesit/Tregtuesit e Pavarur;
- 1 person i emëruar nga dhe që përfaqësonë Konsumatorët e kualifikuar.

Secili anëtarë do të emrohet sipas Nenit 4.1 të kësaj procedure.

Secili anëtar do të ketë të drejtë që të sjell me të në secilin takim maksimum [një] ekspert teknik (ose këshilltar profesional). Ky ekspert teknik nuk do të përbëj antarsi shtesë në KOKQ. Anëtari që ka për qëllim të sjellë ekspert teknik është i obliguar të njoftoj Komisionin mëherët duke përfshirë qështjen që mund të shtrohet me ndihmën e një eksperti të tillë.

KOKQ-ja do ti themeloj dhe t'ju bindet në çdo kohë rregullave dhe procedurave që kanë lidhje me përmbushjen e detyrave të tij.

Personat e emruar për të qenë anëtar duhet të ofrojnë ekspertizë në sfera të ndryshme (psh. Operimet teknike, planifikim dhe administrim të tregut) dhe kur të kërkoet ekspertiza e specializuar OPSTT-ja do të ofroj një ekspertizë siç kërkoet dhe ofrimi i një ekspertize të tillë nuk do të përbëj anëtarë shtesë në KOKQ.

OPSTT-ja do të ofroj sekretariatit për KOKQ dhe një ofrim i tillë nuk do të përfshijë anëtarë shtesë në KOKQ .

Një person do të emrohet vetëm si përfaqësues i një Emëruesi.



### **3.2 Nën - Komisionet**

KOKQ do të themeloj Nën-komisione për të kryer punë të specializuara në sferën e fokusimeve ose përgjegjësive të dhëna Nën-Komisionit.

Në tri (3) vitet e para të jetës së KOKQ-së, KOKQ-ja do të themeloj, jo më pak se, tri (3) Nën- komisione.

Kjo do të përfshijë:

- Nën-Komisionin për Kodet e Rrjetit, Distribucionit dhe Matjes;
- Nën- Komisioni për Standardet Elektrike dhe Kodet e e Paisjeve Elektrike;
- Nën-Komisioni për Kodin e Mbrojtjes së Konsumatorëve.

Të tri (3) Nën-komisionet do të përbëhen nga persona të tillë që KQKO-ja i konsideron të dëshirueshëm.

Secili nën-komision do të nënshtrohet kushteve të shkruara të punës dhe do të ju nënshtrohet procedurave të përcaktuara nga KQKO-ja.

Takimet e nën-komisioneve të KQKO-së, do të arranzhohen në mënyrë që proqesverbali i këtyre takimeve, nëse është e mundur të mund të, prezantohet tek anëtarët në kohë të mjaftueshme për tu marrë në konsideratë para takimit të ardhëshëm të KQKO-së.

### **3.3 Grupet Punuese**

KQKO-ja më tej mundet të themeloj edhe grupe punuese për ta këshilluar atë në ndonjë qështje kohë pas kohe. Këto grupe punuese mund të përbëhen nga Anëtarë dhe/ose personat të cilët KQKO-ja mund ti përcaktoj për ndonjë qëllim.

Këndëvështimet e nën-komisioneve dhe grupeve punuese nuk do të jenë këndvështime të KQKO-së përveç nëse nuk diskutohen dhe bihet dakord nga KQKO-ja.

## **4. Emrimi, Largimi dhe Dorëheqja e Anëtarëve të tjerë përveç Kryesuesit**

### **4.1 Emrimi i Anëtarëve**

KQKO-ja do të përbëhet nga personat që do të emrohen si Anëtarë ashtu siç thuhet në seksionin 4, secili Anëtar i tillë përfaqëson Emruesin e vet përkatës.

Çdo emërues mundet në çdo kohë të largojë nga KQKO-ja Anëtarin e vet të emëruar dhe në vend të tij të emëroj një Anëtarë tjetër, por nuk do të ketë të drejtë që të largoj ndonjë Anëtar të emruar nga ndonjë Emrues tjetër.

Kurdo që emrohet ndonjë Anëtar ose Kryesues, Emruesi i atij Anëtari ose Kryesuesi do të njoftoj Sekretarin me shkrim brenda pesë (5) ditëve të punës që emërimi ka hyrë në fuqi.

Nëse në çfardo kohe ndonjë Emërues nuk do të bëj emërim dhe/ose do të jetë në kundërshtim me atë se kënd të emëroj dhe si rezultat i kësaj asnjë Anëtar nuk përfaqëson Emëruesin:

- ZRrE do të ketë mundësinë, deri sa Emëruesi përkatës nuk ka marr një vendim për emërim dhe nuk e ka njoftuar ZRRE-në në përputhshmëri, të emëroj një Anëtarë ose disa Anëtar në emër të Emëruesit dhe të tërheqë çdo person të emëruar nga Emëruesi; dhe
- në rast që e drejta nuk është ushtruar, KQKO-ja do të konsiderohet si e kompletuar në mungesë të atij Anëtari ose të atyre Anëtarëve.

Asnjë person tjetër nga një individual nuk do të emërohet si Anëtar ose si Anëtar Alternativ.

Secili Anëtar do të ndërprej automatikisht anëtarësin pas takimit të mbajtur të KQKO-së në ditën e parë të punës në muajn Shkurt të secilit dyvjeçar duke filluar nga viti 2007 p.sh. 2009, 2011, 2013 etj. (ose nëse nuk është mbajtur asnjë takim në atë ditë, në takimin që mbahet në datën që bije më së afërti pas asaj dite) por një anëtar i tillë do të jetë i zgjedhur për riemërim.

Në rrethana të tilla secili Emërues mund, duke ju drejtuar me njoftim me shkrim Kryesuesit, të tregoj dëshirën e tij për të riemëruar Anëtarin që i kalon afati i emërimit ose të emëroj një Anëtar të ri në vend të atij Anëtari.

Njoftimet për emërim të një anëtari të ri duhet të dërgohen tek Kryesuesi së paku pesëmbëdhjet (15) ditë pune para takimit nga Emëruesi që përfaqësohet nga secili Anëtar.

Sa i përket një anëtari egzistues, njoftimi për riemërim do të kërkohet të jepet nëse nuk i është dërguar asnjë njoftim si në paragrafin e mëparshëm tek Kryesuesi së paku pesë (5) Ditë Pune para takimit.

Nëse është pranuar vetëm një njoftim për riemërim ose emërim të Anëtarit ose nëse të gjitha njoftimet e marrura janë unanime, person i emëruar në njoftim(et) do të bëhet anëtar me efekt që nga fillimi i takimit.

Nëse është marrur më shumë se një njoftim në lidhje me një anëtar ose nëse të gjitha njoftimet e marrura nuk janë unanime, Kryesuesi do të referoi çështjen tek ZRrE-ja. ZRrE-ja brenda pesë (5) ditëve të punës nga pranimi i kontaktit të fundit referues të Kryesuesit (për atë që sa ZRrE-ja të ketë mundësi të bëjë) nga Emëruesi i përfaqësuar nga ai Anëtar do të kërkojë të inkurajojë pajtim unanimit mes atyre personave në lidhje me riemërimin e Anëtarit.

Nëse marrëveshja është arritur në lidhje me Anëtarin, ZRrE-ja do ta informoj OPSTT-në dhe personat relevantë për rezultatin, dhe më pas varësisht nga rezultati i marrëveshjes:

- personi i ri do ta zëvendësojë Anëtarin ekzistues; ose
- Anëtari ekzistues do të vazhdojë efektivisht me fillimin e takimit të KQKO-së.

Aty ku marrëveshja nuk është arritur, ZRrE do të përcaktoj se kush do të jetë i emëruar dhe do të njoftojë personat relevantë në përputhje me këtë.

Në këto rrethana, varësisht nga rezultat i përcaktimit:

- personi i ri do ta zëvendësojë Anëtarin ekzistues; ose
- Anëtari ekzistues do të vazhdojë efektivisht nga fillimi i atij takimi të KQKO-së dhe do të konsiderohet të jetë i emëruar nga Emëruesi relevant.

## **4.2 Kryesuesi**

Kryesuesi është anëtar i KQKO-së.

Kryesuesi i parë i KQKO-së do të emërohet nga OPSTT dhe do të përbëjë personin e emëruar dhe nga dhe që përfaqëson të licencuarit e OPSTT-së.

Kryesimi i KQKO-së do të jetë rotativ mes Anëtarëve të KQKO-së dhe do të ndryshojë në çdo takim të tretë kuartal (d.m.th. pas 6 muajsh).

Kryesuesi do të kryesoj çdo mbledhje të KQKO-së. Nëse Kryesuesi nuk është në mundësi të jetë prezent në një takim por ka bërë një emërim alternativ, personi alternativ do të ushtroj punën e Kryesuesit.

Nëse as Kryesuesi as personi alternativ i Kryesuesit nuk janë prezent brenda gjysëm ore pas kohës së caktuar për mbajtjen e takimit, Anëtarët prezentë do të zgjedhin një prej atyre që janë prezentë që të ushtroj detyrën e Kryesuesit për atë takim.

Kryesuesi do të ketë fuqinë, pasi që është konsultuar me anëtarët ekzistues, që të emërojë cilindo Anëtar shtesë të KQKO-së në baza të përhershme ose të përkohshme

ashtu si Kryesuesi e konsideron të përshtatshme kohë pas kohe. Anëtarët e tillë shtesë mund të përfshijë si vijon:

- përfaqësues(it) e cilitdo grup konsumatorësh;
- përfaqësues(it) e cilësdo palë të ndërlidhur;
- përfaqësues(it) e Gjeneruesve;
- përfaqësues(it) e Furnizuesve ose Tregtarëve.

Sekretari do të njoftojë anëtarët ekzistues të KQKO-së për emërimet e tilla shtesë brenda dhjetë (10) ditëve të punës që nga ato emërimet.

### **4.3 Sekretari**

OPSTT do të emëroj dhe mund ta shkarkojë Sekretarin dhe do ta njoftojë secilin Anëtar të KQKO-së për identitetin dhe adresën për korrespondencë të Sekretarit sa më shpejtë që është në mënyrë të arsyeshme e mundshme pas emërimit të tij/saj.

Sekretari nuk do të jetë Anëtar i KQKO-së.

Sekretari do ta ketë të drejtën të flasë në çdo takim por nuk ka të drejtë vote në takime.

Detyrat e Sekretarit do të jenë që të kryej punët e përditshme të KQKO-së dhe posaçërisht të:

- merr pjesë në të gjitha takimet e KQKO-së (nëse ai/ajo nuk ka mundësi të merr pjesë në takimet e përmendura, ai/ajo do ta njoftojë Kryesuesin i cili do të emëroj një tjetër individ që nuk është Anëtar për të marrë pjesë në vend të Sekretarit);
- mbajë një regjistër (“Regjistri”) të emrave dhe adresave të Kryesuesit, Anëtarëve dhe të emëruarve alternativëve ashtu si janë emëruar kohë pas kohë; dhe
- mbajë proces verbalin e të gjitha takimeve dhe tja qarkullojë atë tek të gjithë Anëtarët brenda 15 ditëve të punës nga takimi;
- shënoj pjesëmarrjen e atyre Anëtarëve që janë prezentë në takimet e tilla (duke i thirrur Anëtarët prezentë që të nënshkruajnë dhe shtypin emrat e tyre në listën e pjesëmarrjes);
- njoftoj Anëtarët ekzistues për çdo Anëtar të ri të emëruar nga Kryesuesi kohë pas kohe.
- merr pjesë në takimet e jashtëzakonshme dhe dërgon të gjithë ftesat për secilin Anëtar të KQKO-së.

Sekretari do ta bëjë Regjistrin të disponueshëm për inspektim nga cilido Përdorues dhe/ose Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).

#### **4.4 Aletrnativët**

Secili Anëtar do të ketë fuqinë që të emëroj një individ për të qenë Anëtar Alternativ dhe mundet që me diskrecionin e Anëtarit ta largoj secilin alternativë të emëruar kështu.

Çdo emërim ose largim i një Alternativi, përveç nëse Kryesuesi nuk pajtohet ndryshe, do të vihet në fuqi me një njoftim me shkrim nga Anëtari dhe i dorëzuar nga Sekretari ose i qarkulluar në një takim të KQKO-së.

Një Alternativ do të ketë të drejtë të:

- pranoj njoftime për të gjitha takimet e KQKO-së ose takimet e nën-komiteteve ose grupeve punuese të cilave u takon Anëtari;
- merr pjesë në takime të tilla në të cilat Anëtari nuk është personalisht prezent; dhe
- ushtroj dhe shkarkoj të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Emëruesit si një Anëtar në takim.

Për qëllim të procedurave në takime dispozitat e kësaj procedure do të aplikohen sikur Alternativi të ishte një Anëtar.

Një Alternativ nuk do të jetë më Alternativ nëse Emëruesi i Aletrantivit për çfarëdo arsye përfundon së qeni Anëtar.

Referencat në këtë procedurë për një Anëtar, përveç nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, do të përfshijë Aletrnativin e Anëtarit të emëruar si duhet.

#### **4.5 Posti i Zbrazët i Anëtarësisë**

Posti i një Anëtari do të jetë i zbrazët:

- nëse Anëtari jep dorëheqje nga posti përmes një njoftimi të dorëzuar tek Sekretari; ose
- nëse Anëtari është i deklaruar si i bankrotuar ose bie në konflikt të përgjithshëm me kreditorët e tij ose licenca të cilën ai e përfaqëson hyn në likuidim të vullnetshëm apo të pavullnetshëm;
- nëse Anëtari zbulohet se ka një mendje të paqëndrueshme ose është pacient për çfarëdo qëllimi dhe i çfarëdo statuti në lidhje me shëndetin mental; ose
- nëse Anëtari ose Alternativi i Anëtarit dështojnë të marrin pjesë në më shumë se dy takime të njëpasnjeshme të KQKO-së pa e dorëzuar një shpjegim tek Kryesuesi që është arsyeshëm i pranueshëm për Kryesuesin.

- Nëse Emëruesi të cilin ai e përfaqëson e njofton Kryesuesin se ai do të zëvendësohet në të cilin rast Emëruesi do të emëroj një zëvendësim për Anëtarin.

## **5. Përgjegjësitë e Anëtarit**

### **5.1 Përgjegjësitë**

Në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiave të veta, KQKO-ja do të ketë parasysh si duhet nevojën për të promovuar arritjen e objektivave kryesore të KQKO-së të përmendura në Seksionin 2.

Varësisht nga obligimet kryesore të Anëtarit, si një Anëtar i KQKO-së në ushtrimin e fuqive të Anëtarit dhe kryerjes së detyrave të Anëtarit dhe përgjegjësiave si një Anëtar, një Anëtar do të përfaqësoj interesin e Emruesit relevant.

KQKO, secili Anëtar dhe Sekretari do të kenë të drejtë të mbështeten në çdo komunikatë ose dokument që në mënyrë të arsyeshme besohet nga ai person se është i sinqertë dhe korrekt dhe se është komunikuar apo nënshkruar nga një person nga i cili thuhet se është i komunikuar apo nënshkruar.

### **5.2 Dispozitat e Adresave**

Secili Anëtar i ri (dhe alternativ) do t'ia komunikojnë adresën e Anëtarit (ose të aletrnativit) Sekretarit (dhe më pas do t'ia komunikojnë çdo ndryshim në atë adresë Sekretarit) dhe të gjuitha njoftimet e dërguara në atë adresë do të konsiderohen se janë dorëzuara në mënyrë të duhur.

## **6. Takimet, Propozimet dhe Votimi**

### **6.1 Takimet Tremujore**

KQKO-ja do të takohet jo më pak se katër herë në një vit.

Takimet tremujore do të jenë

- Ditën e parë të punës në Gusht;
- Ditën e parë të punës në Nëntor;
- Ditën e parë të punës në Shkurt;
- Ditën e parë të punës në maj;

Takimet e tilla do të thirren nga Sekretari i cili do tu japë Anëtarëve njoftim jo më pak se sa dhjetë (10) ditë pune për një takim të tillë.

Takimi i parë tremujor do të mbahet në Shkurt 2007.

### **6.2 Vendmbajtja e Takimeve**

Vendmbajtja e Zakonshme e takimeve do të jetë në zyrat e OPSTT-së në Prishtinë.

Detajet e vendmbajtjes do të qarkullohen nga Sekretari tek të gjithë Anëtarët para takimeve.

### **6.3 Takimet shtesë**

Takimet shtesë mund të thirren nga kryesuesi ose cilido Anëtar tjetër në kohë të tera mes takimeve tremujore.

Ata që bëjnë thirrje për takime shtesë do të kërkojnë nga Sekretari që të thirrë një takim tjetër duke i dhënë Sekretarit njoftim jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga takimi i tillë.

Njoftimi duhet të jetë me shkrim dhe të përmbajë një përmbledhje të rendit të ditës që propozohet të trajtohet, dhe Sekretari do ta procedoj thirrjen e një takimi të KQKO-së brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e skadimit të njoftimit të tillë.

### **6.4 Njotimi dhe Agjenda e Takimeve**

Të gjitha takimet do të thirren nga Sekretari përmes një njoftimi me shkrim së paku dhjetë (10) ditë pune më parë (përveç ditës kur dërgohet dhe ditës kur dorëzohet), ose me njoftim më të shkurtër nëse kështu pajtohen me shkrim të gjithë Anëtarët.

Në mungesë të Sekretarit, takimin e thirrë Kryesuesi.

Njoftimi për çdo mbledhje do tu ipet të gjithë Anëtarëve dhe do të përmbajë kohën datën dhe vendmbajtjen e takimit, një agjendë dhe një përmbledhje e çështjeve që do të trajtohen.



Përrjashtimi aksidental i dërgimit të njoftimit, ose mospranimi i njoftimit për një takim nga një person që ka të drejtë të marrë njoftimit nuk do ta zhvleftësojë procedurën e atij takimi.

Përrmes njoftimit tek Sekretari, secili Anëtar mund të kërrkoj që çështjet shitesë të shqyrtohen në takim nëse një njoftim i tillë është dhënë së paku dhjetë (10) ditë pune (përveç ditës së dërgesës dhe ditës së dorëzimit) para datës së mbajtjes së takimit, dhe ato çështje do të përrfshihen në një agjendë të reviduar për takim.

Sekretari do ta qarkullojë agjendën e reviduar tek secili Anëtar sa më shpejtë që është e mundur.

## **6.5 Procedurat e Takimit**

KQKO mund të takohet për të trajtuar punët dhe shtyej ose ndryshe ta rregullojë takimin e vet, ashtu si mendon se është e përrshtatshme.

Takimi i KQKO-së mund të vazhdojë nëse ka, së paku, jo më pak se pesë (5) Anëtarë të pranishëm.

Nëse, në një takim të KQKO-së, janë prezent më pak se 5 Anëtarë, takimi do të shtyhet për një ditë, kohë dhe vend për cilin Sekretari do ti njoftoj Anëtarët brenda tri (3) ditëve pune nga shtyerja.

Një takim i shtyer në këtë mënyrë nuk do të thirret për tu mbajtur brenda një jave pas shtyerjes por mund të thirret me njoftim prej jo më pak se dhjetë (10) ditë pune paraprakisht

Nëse në një takim të tillë të shtyer pesë (5) Anëtarë nuk janë prezent takimi do të mbahet në çdo rast.

Vetëm çështjet e identifikuara në agjendën e dorëzuar do të diskutohen në një takim por kjo nuk do të parandalojë që çështjet e ngritura nën pikën “Të tjera” të diskutohen.

Të gjitha aktet e bëra nga një takim i KQKO-së ose një nën-komitet ose një grup punues, pa e përrjashtuar se më vonë mund të zbulohet se ka patur ndonjë defekt në emërimin e një Aëntari, do të jenë të vlefshme sikur ai person të ketë qenë i emëruar si duhet.

## **6.6 Përrfaqësimi**

Kryesuesi dhe secili Anëtar tjetër do të kenë të drejtë të marrin pjesë dhe flasin në çdo takim të KQKO-së.

Anëtarët mund të sjellin Ekspertin Teknik (një Këshilltar Profesional) në takimin e KQKO-së për një temë të caktuar të Agjendës.

Pjesëmarrja dhe numri i këshilltarëve do të jetë i kufizuar në marrëveshje të anëtarëve të KQKO-së ashtu që të mos ndërhyjë në punën e lehtë dhe efikase të KQKO-së. Në rast se

marrëveshja nuk arrihet, Kryesuesi do të vendos, pasi të ketë marrë parasysh opinionet e shprehura nga Anëtarët e KQKO-së.

## **6.7 Propozimet**

Një Anëtar mundet që kohë pas kohe të bëjë një propozim (“Propozim”) në lidhje me:

- Kodet e Rjetit, Distribucionit dhe Matjes;
- Kodet e Standardeve Elektrike dhe Paisjeve Elektrike;
- Kodi për Mbrojtjen e Konsumatorëve.

Secili propozim do të:

- Jetë me shkrim;
- Paraqet arsyeshëm po jo detale të tepruara natyrën dhe propozimin e Propozuesit;
- Dorëzohet tek sekretari i KQKO-së jo më pak se dhjetë (10) Ditë Pune përpara
- Vendoset në agjendë për diskutim nga Anëtarët në Takimin e ardhëshëm.

Në takimin e thirrur sipas rregullave të KQKO-së, propozimi do të prezantohet tek anëtarët nga Anëtari propozues, i cili do të përpiçet të përgjigjet çdo pyetje fillestare të cilat Anëtarët mund ti kenë në lidhje me Propozimin ose prezantimin.

KOKQ-ja do të diskutoj Propozimin.

Pasi të ketë:

- Ndëgjuar prezantimin e anëtarit që bën prezantimin;
- Diskutuar propozimin; dhe
- Të ketë pasur mundësi të shtroj pyetje anëtarit që e bën propozimin në lidhje me propozimin.

Kryesuesi duke llogaritur mendimet e KQKO-së mund të përcaktoj që propozimi:

- Nuk meriton ndonjë konsideratë të mëtutjeshme;
- Do të dorëzohet nga OPSTT-ja tek ZRrE-ja, për aprovim/modifikim/shtesë për kodet përkatëse për aprovim.

Aplikacioni për modifikim/ndryshim/shtim do të përfshijë propozimin original dhe këndëveshtrimet dhe konsideratat e KQKO-së ose meriton konsiderim konsiderim të mëtutjeshëm.

Kryesuesi mund të dorëzoj Propozimin tek Nën-komisioni përkatës në koordinim me KQKO-në.

Secili Nën-komision do të udhëhiqet nga Anëtarët e KQOK-së ose nga ndonjë i nominuar tjetër që caktohet nga KQKO-ja i cili do të koordinoj konsiderimin e mëtutjeshëm të Propozimit.

Nën- Komisioni do të raportoj tek KQOK-ja do në secilin takim të KQKO-së me progresin e nënkomisionit.

Kur të kompletohet puna e Nën-komisionit, shqyrtimi i ardhëshëm final nga KQKO-ja, KQKO-ja përmes kryesuesit mund të aplikoj tek ZRRE-ja për rishikim të Kodeve përkatëse dhe duke vepruar kështu do të përfshijë Propozimin original dhe këndvështrimet dhe konsiderata e KQKO-së.

## **6.8 Votimi**

Secili anëtar i KQKO-së do të ketë të drejtën e një vote.

Sapo që ose kur një propozim është vënë për tu votuar nga anëtarët e KQKO-së, vendimi I rezultuar do të jetë kusht i zgjedhjes së KQK\_së dhe do të regjistrohet si I tillë në Procesverba.

Në rast të barazisë së votave, Kryesuesi mund të përdor votën e dytë ose të tërheqë votën e ose të kundërshtoj propozimin.

## **6.9 Proqesverbali**

Sekretari do të qarkulloj kopjet e proqesverbalit të secilit takim të KQKO-së tek secili anëtar sa më shpejtë që praktikisht të jetë e mundur (dhe në çfardo rasti Brenda dhjetë (10) ditëve të punës) pas mbajtjes së takimit përkatës.

Secili anëtar do të njoftoi Sekretarin për aprovimin ose kundërshtimin e tij të proqesverbalit Brenda 15 ditëve të punës pas marrjes së proqesverbalit.

Anëtari i cili dështon të njoftoi sekretarin do të konsiderohet se ka aprovuar proqesverbalin.

Aprovimi ose kundërshtimi i minutave nuk do të ketë ndikim me vlefshmërinë e procesimit të takimit të KQKO-së për të cilin është mbajtur proqesverbali.

Nëse sekretari merr ndonjë koment në minuta, atëher sekretari duhte të përfshijë ato aspekte të proqesverbalit për të dilat ka mosmarrveshje, në pikën e parë të agjendës së së takimit të KQKO-së.

## **6.10 Gjuhët e Punës**

Gjuhët e punës të KQKO-së do të jenë Shqip dhe Anglisht.

Proqesverbali i secilit takim do të përgaditën në shqip dhe do të përkthehen në anglisht.

Verzioni shqip i procesverbalit do të mbizotroj në rast se ka ndonjë konflikt ose mospërputhje në mes të verzionit shqip dhe anglisht të procesverbalit.  
Dokumentet e shkruara (p.sh propozimet) e dorëzuara ose të furnizuara tek KQKO-ja do të ofrohen në shqip ose në anglisht.

## **7. Shpenzimet e Përgjithëshme dhe të Posaqme**

### **7.1 Shpenzimet e përgjithëshme të KQKO-së**

Shpenzimet e shkaktuara nga, dhe të shkaktuara nga, dhe në lidhje me, operimet e KQKO-së do të jenë përgjegjësi e anëtarëve të KQKO-së dhe do të ndahen në mnyrë të barabart, the precise details and form of which will be decided by and agreed among the Members of the OCGC.

### **7.2 Shpenzimet e Ekspertëve Teknik (këshillatrët Profesional)**

Shpenzimet (psh taksat dhe hargjimet) e ndonjë eksperti teknik (ose këshilltari Profesional) të kërkuara dhe të emruara nga ndonjë anëtar specific për të këshilluar atë anëtar do të jenë përgjegjësi dhe do të paguhet nga ai anëtar.

## 8. Amendamentet e Procedurës së Administrimit

Nëse cilido Anëtar e konsideron të përshtatshme që ti bëjë amendamente kësaj Kushtetute, Anëtari do të këshillojë Sekretarin i cili, përveç nëse amendamenti i propozuar ka pasoja minore, do ta njoftojë secilin Anëtar në mënyrë të duhur dhe do të bëjë thirrje për përfaqësim brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës kur është bërë një ftesë e tillë në lidhje me amendamentin e propozuar.

Sekretari, brenda tri (3) ditëve të punës menjëherë pas skadimit të atyre dhjetë (10) ditëve të punës, do ti dërgoj secilit Anëtar dhe ZRRE-së kopjet e të gjitha përfaqësimeve të pranuar.

OPSTT-ja do të vendos, bazuar në këto përfaqësime, nëse procedura duhet të amendamentohet dhe do të njoftojë ZRRE-në në mënyrë të duhur.

Nëse amendamenti i shqyrtuar nga Sekretari është me pasoja minore, ai do të përfshihet në agjendën e takimit pasues të KQKO-së dhe mund të aprovohet me pajtimin e të gjithë Anëtarëve të pranishëm.

Versionet e reja do të miratohen formalisht kur të nënshkruhen nga përfaqësuesit e Kryesuesit dhe Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) në KQKO.

Kjo procedurë është miratuar në datën që për herë të parë është përmendur më lartë nga personat nënshkrimet e të cilëve janë më poshtë.

Nënshkruar.....

Data.....

Nënshkruar.....(nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE))

Data:.....

Këshilla jonë në këtë dokument është e kufizuar në konkluzat specifike të vendosura në këtë mënyrë dhe është e bazuar në tërësinë dhe saktësinë e fakteve të përmendura, supozimeve dhe përfaqësimeve më lartë. Nëse cilido nga faktet, supozimet ose përfaqësimet e mëparshme nuk është tërësisht i plotë dhe i saktë, është imperativ që net ë njoftohemi menjëherë, meqë pasaktësia dhe joplotënia mund të ketë një ndikim material në konkluzat tona. Në pasqyrimin e këshillës sonë, ne mbështetemi në dispozitat relevante të legjislacionit të tanishëm në Kosovë, rregulloret nën të, dhe interpretimet juridike dhe administrative nga kjo. Këto autoritete i nënshtrohen ndryshimeve, retroaktivisht dhe/ose në të ardhmen, dhe çdo ndryshim i tillë mund të ndikoj vlefshmërinë e konkluzave tona.